



## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### **Vendimi 2020/K01**

**Data: 27.01.2020**

#### **Development Conference TE - 2020**

Z. Shkelzen Domi do të merr pjesë në Development Workshop 2020 i cili do të zëvendësojë z. Hysni Ymeri pasi ka konfirmuar se nuk ka mundësi të merr pjesë.

Development Conference organizohet nga Tennis Europe në mars 2020, në Kretë, Greqi.

### **Vendimi Nr. 2020-20**

**Data: 29 Mars 2020**

#### **Asistencë 2 mujore për trajnerët e tenisit**

Si pasojë e gjendjes aktuale të renduar nga pandemia "Covid 19", gjegjësisht humbjes së të hyrave që ka shkaktuar, bordi me shumicë votash marrë vendim të ofrojë asistencë modeste 2 mujore për 10 trajnerët me aktive të tenisit.

Brenda mundësive buxhetore, trajnerëve do t'iu ndahen nga 150 euro për muajt mars dhe prill. Trajnerët që përfitojnë nga ky program janë:

1. Arian Ibrahim
2. Art Baruti
3. Astrit Xerxa
4. Bajram Ibrahim
5. Burim Citaku
6. Durim Morina
7. Edon Ademi
8. Festim Ibrahim
9. Granit Bajraliu
10. Kreshnik Arifi
11. Lorik Haxhishabani



**Vendimi 2020/K02**

**Data: 31.03.2020**

**Pezullimi i të gjitha aktiviteteve të tenisit si pasojë e COVID 19**

Pezullohen të gjitha aktivitetet e tenisit në harmoni me Vendimin e Qeverisë Nr.01/07 të datës 11/03/2020 me qëllim të parandalimit e përhapjes të virusit Corona “COVID 19”.

Pikët e rankingut do të ngrihen dhe mbesin të njëjtat e javës 11-2020 deri në garat e ardhshme.

Ky vendim është i vlefshëm deri në njoftimin e ardhshëm nga FTK.